



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E GJAKOVËS
 OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

ARKIVA DALËSE
 IZLAZNE ARHIVE
 OUTPUT ARCHIVES

Nr. Inv./Br. Inv. Q-01101-9924
 Data/Datum/Date 27.02.2026
 Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____/2026

Dt. 27.02.2026

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, në mbledhjen e mbajtur me dt.27.02.2026, pas diskutimeve lidhur me pikën e 7 të Rendit të Ditës: Propozim Vendimi për miratimin e Raportit të Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga fatkeqësitë Natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Gjakovës, e miratoi këtë:

V e n d i m

1. Miratohet Raporti i Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga fatkeqësitë Natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Gjakovës.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve të shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Gjakovës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.


4.Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini.
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
- Arkivit.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Shefqet Shehu



GJAKOVA



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Data/nr	26.02.2026
Për:	Shefqet Shehu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Lënda:	Propozim vendim për shqyrtim dhe miratimin e Raportit të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Gjakovës

Të nderuar,

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 58 shkronja h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 46 shkronja h të Statutit të Komunës së Gjakovës, dispozitave të Ligjit Nr. 04/-L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, si dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, me datën 26.02.2026 e parashtron në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

PROPOZIM VENDIM

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës të shqyrtoj dhe miratojë Raportin e Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës e Gjakovës.
2. Pjesë përbërëse e këtij propozim - vendimi janë: Raporti i Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Gjakovës.
3. Obligohen organet e administratës për kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Me respekt!



REFERENC-Ë, DT:	01 / Zyrtare / 2026 datë 25.02.2026
PËR/ZA/TO:	Z. Ardian Gjini - Kryetar i Komunës së Gjakovës
Ce:	Arkivit
NGA/OD/FROM:	Devoll Kerleshi - Kryesues i Komisionit për Vlerësimin e dëmeve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport mbi dëmet nga vërshimet e dt. 05-08 Janar 2026

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 04/-L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, si dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Komisioni Komunal i themeluar me vendim të Kryetarit të Komunës së Gjakovës me datë 25.02.2026 nxjerr këtë:

R A P O R T

Për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në ekonomitë familjare në biznese dhe në kulturat bujqësore - bletari në territorin e Komunës së Gjakovës në muajin Janar të vitit 2026, vlerësimi i dëmeve ka filluar që nga data 12/01/2026, pas vlerësimit në teren për secilën kërkesë, nxjerrë pasqyrën e dëmeve më sa vijon:

Nr.	Profili i dëmit	Numri i rasteve	Vlera e dëmit
1.	Dëme në ekonomi familjare	236	2,276,476.93 €
2.	Dëmet në Biznese	17	299,537.24 €
3.	Dëmet në kulturat bujqësore - bletari	16	223,836.44 €
Totali :			2,799,850.61 €

Shënim: pjesë përbërës e këtij raporti është lista e personave individual e cila përfshin të dhënat personale të dëmtuarve.

Me qëllim të mbrojtjes së të dhënave personale, lista nuk do të publikohet apo të shpërndahet tek institucionet tjera përveç në Agjencinë dhe në Komisionin Qendror.

Pas shqyrtimit dhe miratimit të këtij raporti në Kuvendin Komunal, i njëjti do të dërgohet në afat ligjor në Agjencinë dhe në Komisionin Qendror së bashku me listën dhe dokumentacionin individual për secilën palë të dëmtuar.

RIKAPITULLIM

Komisioni nga data 12.01.2026 ka dalur në teren për verifikimin e dëmeve të shkaktuara në ekonomitë familjare, biznese, kulturat bujqësore - bletari dhe në erozion.

Nr.	Përshkrimi i lëndëve	Numri i rasteve
1	Ekonomitë familjare	236
2	Dëmet në Biznese	17
3	Dëmet në kulturat bujqësore - bletari	16
4	Kërkesë për rregullimin e kulmit	14
5	Kërkesa të anuluar	26
6	Kërkesa jashtë afatit kohorë	3
7	Erozion të tokës	17
8	Infrastrukturë	15
<u>Totali i lëndëve:</u>		344

Komisioni:

1. Devoll Kerleshi, Kryesues i Komisionit
2. Elvane Qarkagjia, anëtare
3. Arben Hulaj, anëtar
4. Sharr Mullaxhela, anëtar
5. Robert Marjakaj, anëtar

